




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 , nenit 12 parag. 1 nënparag. 1.1, dhe nenit 20 parag.1 dhe 2 të Ligjit për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës, nr.03/L-149 , lidhur me nenin 15 parag. 1 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit , Komuna e Gjiçanit (drejtorja e arsimit) shpall :

K o n k u r s

Vendi i punës : Një sekretar të shkollës
Institucioni /shkolla fillore “ Mulla Idriz Gjilani”-Velekincë
Koeficienti : 6.3
Lloji i emërimit : i karrierës
Kohëzgjatja : zbatohet periudha provuese prej 12 (dymbëdhjetë) muajve.
Orari i plotë : 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Është përgjegjës për zbatim të ligjshmërisë në shkollë,
- Bënë përgatitjen e projekt- akteve normative të shkollës, kryen ndryshimet dhe plotësimet e tyre,
- Kryen punët profesionale dhe administrative,
- Udhëheqë protokollin,
- Mbanë librin amë të punëtorëve,
- Bënë pranimin e postës,
- Kujdeset për mirëvajtjen e punëve të punëtorëve ndihmës-teknik,
- Udhëheq arkivin e shkollës,
- Kryen edhe punë të tjera juridike administrative,
- Për punën e kryer jep llogari drejtorit të shkollës përkatëse.

Kushtet për punësim :

- Fakulteti juridik, me sistem 4 (katër) vjeçar.
- Njohja e legjisllacionit nga lëmia e punës,
- Njohje e shkëlqyeshme e punës me kompjuter

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartshënuar duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin në kopje si vijon;

- Dëshmi mbi përgatitjen profesionale,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Letër rekomandimet,
- Dokumentin e identifikimit

Aplikacionet merren dhe të plotesuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunes së Gjiçanit,përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë vend të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Afati i aplikimit është 15 ditë,nga shpallja publike në gazetë dhe në mjetet e tjera të informimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për testim me shkrim dhe intervistë me gojë. Shërbimi Civilë i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Drejtori i drejtorisë

Bujar Nevzati